

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Albsig Sh.a operon në tregun e sigurimeve në Shqipëri prej 17 vitesh duke qenë pjesë e grupit më të madh në vend Kastrati Group. Ajo përfaqësohet me 2 Shoqëri të tjera Albsig Jetë Sh.a. dhe Albsig Invest Sh.a. Siguria, stabiliteti financiar dhe një e ardhme e sigurtë për punonjësit, klientët, bashkëpunëtorët dhe aksionarët janë misioni ynë; qëllimi ynë është të sigurojmë zhvillim profesional dhe personal të punonjësve, njëkohësisht të jemi partnerë me klientët e siguruar duke ju ofruar mbështetje të plotë në fushën e sigurimeve, duke qenë këmbëngulës në krijimin e një fryme pozitive, kulture të mirëfilltë biznesi, trajnime të vazhdueshme dhe investim për punonjësit; zhvillim i vazhdueshëm i produkteve të sigurimit dhe atyre ndihmëse që ndikojnë në procese më optimale të biznesit.

Të gjithë ata që pëlqejnë kontaktin e drejtpërdrejtë me klientin, shitjen në terren ose ata që kanë ekperiencë në fushën e shitjes dhe aftësi të mira komunikimi, që kanë dëshirë të punojnë në grup, janë të prirur drejt rezultateve konkrete, që janë të përkushtuar e korrekt, të aplikojnë në pozicionin e punës si vijon:

- **“Specialist shitje dhe marketingu”**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Njohja, reklamimi dhe prezantimi i gjithë gamës së produkteve të sigurimit që Shoqëria ALBSIG ofron;
- Identifikimi i klienteve potencialë në zona të ndryshme të Tiranës;
- Identifikimi i nevojave të klientit dhe përputhja e këtyre nevojave me shërbimet dhe/ose produktet e kompanisë që janë specifike për nevojat e klientit;
- Shitja e produkteve të kompanisë tek klientët potencialë individ apo subjekte;
- T'i ofrojë klientit nivelin më të lartë të shërbimit duke iu përgjigjur në mënyrë efektive gjatë dhe pas procesit të shitjes;
- Zhvillimi i marrëdhënieve të biznesit me klientë të rinj apo aktualë;
- Përbushja e objektivave/targets të shitjeve personale dhe ato në grup.
- Detyra të tjera të caktuara.

Kualifikimet dhe aftësitë e aplikantit:

- Diplomë bachelor;
- Njohuri të mira kompjuterike në programet e paketës Microsoft Office, internet;
- Njohuri të mira të gjuhës Angleze (të shkruar dhe të folur);
- Aftësi komunikimi, prezantimi dhe negocimi efektiv;
- Aftësia për të krijuar marrëdhënie afatgjata me klientët dhe për të ofruar shërbim ndaj klientit;
- I Vetë-motivuar dhe energjik.

Të interesuarit, duhet të dorëzojnë brenda datës 18.10.2021 C.V. e tyre me fotografi në Departamentin e Burimeve Njerëzore të “ALBSIG” Sh.a. në adresën: Rruga e Barrikadave, Pallatet 9 kateshe, Nr. 1001, Tiranë ose me e-mail: info@albsig.al. Vetëm personat e perzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.